



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1906/12 Prot.

Tiranë, më 21.12.2020

V E N D I M

Nr. 56 datë 21.12 2020

**PËR MIRATIMIN E PAGESËS SË ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË
PROMOVIMIT TË PERSONELIT AKDEMIK DHE SEKRETARISË
MBËSHTETËSE**

Në mbështetje të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e Republikës së Shqipërisë", neni 49, VKM nr. 656 datë 31.10.2018 "Për përcaktimin e masës së pagesave së shpërblimit të këshillave , bordeve ose komisioneve..." në Vendimin e Senatit nr. 36, datë 13.11.2020 "Për ngritjen e Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik për dhënien e titujve "Profesor" dhe "Profesor i Asociuar" në Universitetin e Sporteve të Tiranës" (në vijim KPPA), në pikën 1, neni 15 të Rregullores së Veprimtarisë së KPPA e miratuar me Vendim Senati nr.43, datë 27.11.2020, Vendimin e Senatit nr. 56 datë 15.12.2020" Për miratimin e pagesës së anëtarëve të komisionit të promovimit të personelit akademik dhe sekretarisë mbështetëse, Bordi i Administrimit ,

V E N D O S I:

1. Të miratojë tarifën e pagesës për kryetarin dhe anëtarët komisionit të promovimit të personelit akademik në vlerën 25 000 lekë në muaj.
2. Të miratojë tarifën së pagesës së personave të stafit administrativ që ndodhen në mbështetje të komisionit të promovimit të personelit akademik, në sekretarinë e tij, për detyra të përcaktuara jashtë detyrave funksionale të tyre, si më poshtë vijon:

E. O.	15 000 lekë
Xh. L.	15 000 lekë

3. Efektet financiare fillojnë nga momenti i fillimit të punës.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij Vendimi Administratori , Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë publikohet në www.ust.edu.al dhe tek trasparenca universitare.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Hysen Dëmi

